



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA - MUNICIPALITY**

**HANI I ELEZIT**

**PLANI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE  
2016 – 2020**

**KOMUNA HANI I ELEZIT**

<b>Përmbajtja</b>	
<b>SHKURTESAT</b> .....	4
<b>PËRKUFIZIMET</b> .....	5
<b>Fjala e Kryetarit të Komunës</b> .....	7
<b>1. Hyrje</b> .....	8
1.1. Misioni, vizioni dhe objektivat .....	8
<b>2. Profili i Hani i Elezit</b> .....	9
2.1. Korniza kombëtare ligjore dhe politikat .....	10
2.2. Korniza lokale ligjore .....	11
<b>3. Gjendja aktuale</b> .....	12
3.1. Grumbullimi dhe përbërja e mbeturinave .....	12
3.2 Deponimi i mbeturinave .....	15
3.3 Analizat e përbërjes së mbeturinave .....	15
3.4. Studimi në terren i vitit 2011.....	16
<b>4. PLANIFIKIMI OPERACIONAL I MENXHIMIT TE MBETURINAVE (2016-2020)</b> .....	17
4.1. Modeli i zgjedhur i operimit.....	17
4.2. Synimet kryesore ne fushën e menaxhimit të mbeturinave.....	18
4.3. Hartimi i Rregulloreve Komunale për rregullimin e fushës se menaxhimit te mbeturinave.....	18
4.4. Sektori për menaxhimin e mbeturinave .....	18
4.5. Skemat e Ofrimit te Shërbimit te Menaxhimin te Mbeturinave .....	19
4.6. Themelimi i Ndërmarrjes Komunale Publike .....	20
<b>5. PLANI FINANCIAR</b> .....	21
5.1. Supozimet kryesore në planin financiar.....	21
5.2 Kostot operative dhe të investimeve.....	23
5.3 Mirëmbajtja dhe amortizimi.....	23
5.5.Tarifat e deponisë / vend shkarkimit .....	24
5.7. Investimet e reja të nevojshme kapitale.....	24
5.8.Tarifat komunale për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave .....	25

---

5.9. Kostot e shërbimit.....	26
5.10 Transporti .....	27
5.11. Zbatimi i planit faktorët kryesor të veprimit për periudhën 2016-2020.....	28
6. Plani i Veprimit, Buxheti dhe koha e implementimit .....	30
7. Ndërgjegjësimi i publikut .....	33
7.1. Strategjia e Komunikimit të Marketingut: .....	33
Aneks I: Zbatimi i mbulimit të zonave për periudhën 2016-2016 bazuar në kriteret e përcaktuara .....	34

## SHKURTESAT

<b>AKK</b> Asociacioni i Komunave të Kosovës	<b>BD</b> Bordi i Drejtorëve
<b>BE</b> Bashkësia Evropiane	<b>AKMM</b> Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit (MMPH)
<b>KKMD</b> Kompania Kosovare për Menaxhimin e Deponive	<b>MEF</b> Ministria e Ekonomisë dhe Financave
<b>MMPH</b> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	<b>MAPL</b> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>NJPM</b> Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (MEF)	<b>NP</b> Ndërmarrjet Publike
<b>PSP</b> Pjesëmarrja e Sektorit Privat	<b>KRGM</b> Kompanitë Regjionale për Grumbullimin e Mbeturinave
<b>SCO/ZZB</b> Zyra Zvicerane për Bashkëpunim	<b>PMMN</b> Plani për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta
<b>AMN</b> Analizat e Mbeturinave të Ngurta	<b>ZRRUM</b> Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina
<b>AKK</b> Asociacioni i Komunave të Kosovës	<b>BD</b> Bordi i Drejtorëve
<b>BE</b> Bashkësia Evropiane	<b>AKMM</b> Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit (MMPH)
<b>KKMD</b> Kompania Kosovare për Menaxhimin e Deponive	<b>MEF</b> Ministria e Ekonomisë dhe Financave
<b>MMPH</b> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	<b>MAPL</b> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>NJPM</b> Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (MEF)	<b>NP</b> Ndërmarrjet Publike
<b>PSP</b> Pjesëmarrja e Sektorit Privat	<b>KRGM</b> Kompanitë Regjionale për Grumbullimin e Mbeturinave
<b>PKMM</b> Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave	<b>PMMN</b> Plani për Menaxhimin e Mbeturinave të Ngurta
<b>AMN</b> Analizat e Mbeturinave të Ngurta	<b>ZRRUM</b> Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

## PËRKUFIZIMET

**Mbeturinë** – është çdo substancë ose lëndë që i përket një kategorie të mbeturinave të cilën zotëruesi e hedh, mendon ta hedh, ose është e nevojshme që të hidhet.

**Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton mbledhjen, bartjen, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklim-in dhe deponimin e mbeturinave, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimtarive dhe kujdesin e mëtejshëm të deponive, duke përfshirë edhe veprimet e ndërmarra nga tregtari apo ndërmjetësuesi.

**Trajtimi i mbeturinave** – nënkupton procesin fizik, kimik, biologjik, termal, duke përfshirë edhe klasifikimin, që ndryshon karakteristikat e mbeturinave ashtu që të zvogëlohet vëllimi apo natyra e dëmshme e tyre, të lehtësohet manipulimi me mbeturina ose të përmirësohet riciklimi.

**Grumbullimi i mbeturinave** – është aktivitet sistematik i grumbullimit, klasifikimit dhe/ose përzierjes së mbeturinave për qëllime të transportit.

**Mbeturinat e rrezikshme** – janë mbeturinat që kanë së paku një nga karakteristikat në vijim: shpërthyes; oksiduese; të ndezshme; ngacmuese; të dëmshme; toksike; kancerogjene; korrozive; infektive; teratogjenike; mutagjene; lirojnë gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose acidin; në gjendje të krijojnë një tjetër substancë të ‘rrezikshme’; ekotoksike.

**Mbeturinat e parrezikshme** – janë mbeturinat që nuk paraqesin ndonjë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

**Mbeturinat inerte** – janë mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar. Mbeturinat inerte nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe/ose nëntokësore.

**Mbeturinat komunale** – janë mbeturina nga amvisëritë, si dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre janë të ngjashme me mbeturinat shtëpiake.

**Mbeturinat komerciale** – nënkuptohen mbeturinat nga lokalet që përdoren tërësisht apo kryesisht për qëllimet e tregtisë ose biznesit, ose edhe për qëllime sportive, rekreative, arsimore, apo argëtuuese, por nuk përfshijnë mbeturinat shtëpiake ose mbetjet industriale.

**Mbeturinat industriale** – janë mbeturina që prodhohen nga aktivitetet ose proceset industriale, artizanale dhe veprimtari të tjera të prodhimit.

**Kompostimi** – është një proces i kontrolluar biologjik për zbërthimin e mbeturinave organike nga mikroorganizmat në prani të oksigjenit, rezultati i së cilës është kompostimi.

**Mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet** – përfshijnë mbeturina të prodhuara gjatë ndërtimit, të ri-modelimit, riparimit të objekteve të banimit individual dhe kolektiv, objekteve tregtare etj. Komponentët kryesorë të këtyre mbeturinave janë: guri, betoni, tulla, komponentë hekuri, komponentë plumbi, komponentë elektrike etj.

**Mbeturinat bujqësore** – përfshijnë mbeturinat që janë prodhuar gjatë aktivitetëve të ndryshme bujqësore, si: përdorimi i pesticideve, prodhimi i verës, përpunimi dhe prodhimi i aktivitetëve bujqësore dhe blegtorale.

**Mbeturinat infektive** – përfshijnë mbeturinat me potencial të rrezikut të lartë të infektimit nëse punohet ose veprohet me to. Ato mund të dëmtojnë shëndetin e qytetarëve dhe mjedisin. Këto mbeturina gjëndërohen nga spitalet dhe institucionet e tjera shëndetësore, kafshët e ngordhura, thertoret etj.

**Mbeturinat speciale** – përfshijnë mbeturinat radioaktive, kontejnerët e përdorur për gazrat nën presion, mbeturinat që përmbajnë përqendrim të lartë të metaleve të rënda toksike (arseniku, plumbi etj.), produktet kimike të skaduar.

**Mbeturinat kimike dhe farmaceutike** – përfshijnë produkte kimike dhe farmaceutike brenda paketimit të tyre.

**Djegia** – trajtimi termik i mbeturinave. Ky është një proces i komplikuar, për shkak se furrat e përdorura për djegie duhet t'i përmbushin standardet e caktuara për mbrojtjen e mjedisit. Ky është një proces i shtrenjtë dhe ekonomikisht i pafavorshëm por i nevojshëm.

**Mbeturinat nga qelqi** – kryesisht janë mbeturinat e paketimit që mund të riciklohen me sukses.

Mbeturinat nga plastika – janë mbeturina që nuk degradohen biologjikisht,, të krijuara kryesisht për qëllime të paketimit.

**Mbeturinat organike** - janë mbeturina që degradohen biologjikisht përmes proceseve aerobe apo anaerobe. Në këtë grup të mbeturinave hyjnë edhe mbeturinat organike të klasifikuara si mbeturina nga ushqimi, mbeturinat bujqësore, letra etj.

**Riciklimi** – nënshtrimi i mbeturinave ndaj ndonjë procesi ose trajtimi për t'i bërë tërësisht apo pjesërisht të ri-përdorshme.

**Përpunues i mbeturinave**– kompania e përfshirë në mbledhjen e materialeve të riciklueshme nga mbledhësit individual apo nga pikat e grumbullimit. Ata janë “ndërmjetësit” që i përgatisin materialet për eksport, ose për transport deri te uzina.

**Pika e grumbullimit** – Disa përpunues të mbeturinave kanë vendosur pika të grumbullimit nëpër tërë rajonin e tyre përkatës ose të komunës. Këto pika janë thjeshtë pika të shkarkimit për mbledhësit individual. Kur materiali ka arritur një peshë të caktuar, përpunuesit e mbeturinave i largojnë materialet nga kjo pikë dhe i dërgojnë ato në institucionin qendror për përpunim të mëtutjeshëm.

**Uzinat** – Gjithashtu të njohura si objekte të prodhimit, këto kompani nuk janë vetëm të angazhuara në mbledhjen e materialeve të riciklueshme, por edhe për përdorimin e materialeve për të krijuar produkte finale. Produktet finale që gjenden në Kosovë janë fshesat plastike dhe brushat, rrethojat dekorues nga alumini, tubat plastike dhe qeset për mbeturina, dhe kartonët për vezë.

## Fjala e Kryetarit të Komunës

Për komunën e Hanit të Elezit, që nga fillimi i funksionimit të saj, menaxhimi i mbeturinave është konsideruar si një sfidë me të cilën kjo komunë duhej të përballej dhe të gjejë një zgjidhje afatgjatë. Nevoja për investime në kushte e rrethana të kufizuara financiare, nevoja për ndërgjegjësimin e qytetarëve por edhe problemet në interpretimet ligjore kanë bërë që kjo sfidë të jetë aktuale edhe sot e kësaj dite.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë, komunat janë kompetente për sigurimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë këtu furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza dhe menaxhimin e mbeturinave, mirëpo mospërputhja e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe pronësia e ndërmarrjeve publike ka bërë që problematika e menaxhimit të mbeturinave të ngritet në një nivel më të lartë të shqyrtimit dhe analizës. Sipas Ligjit për Mbeturinave, komunat kanë të drejtë t'i përgatisin planet e veta lokale për menaxhimin e mbeturinave të ngurta dhe t'i bëjnë planet e duhura operative për grumbullimin e mbeturinave në mënyrë më efektive.

Sidoqoftë, angazhimi i komunës si institucion që të vihet në shërbim të qytetarëve asnjëherë nuk është vënë në pyetje, pa marrë parasysh sfidat dhe problemet qoftë financiare, funksionale apo ligjore.

Në këtë drejtim përgatitja e një dokumenti për "menaxhimin e mbeturinave" vetëm sa e dëshmon seriozitetin dhe përkushtimin e komunës së Hanit të Elezit që këtij problemi t'i qaset me tërë kapacitetin e vet, dhe të jetë komuna e parë në Republikën e Kosovës që do ta ketë një dokument gjithëpërfshirës.

Harmonizimi i këtij dokumenti me legjislacionin kombëtar dhe Direktivat e BE-së na bënë të besojmë se kemi arritur të hartojmë një strategji afatgjatë të menaxhimit të mbeturinave.

Koncepti i detajuar për menaxhimin e mbeturinave në qytet dhe në vendbanimet rurale të Hanit të Elezit, themelimi i një rrjeti funksional për grumbullimin e mbeturinave, krijimi i një plani për menaxhimin e mbeturinave dhe mbështetja financiare e programeve për ngritjen e vetëdijes publike si dhe themelimi i një ndërmarrjeje publike që i parasheh ky dokument, do të jetë strategjia e komunës së Hanit të Elezit për ta menaxhuar këtë problematikë në mënyrë afatgjatë. Për të ardhur deri te ky dokument është dashur kohë, angazhim dhe përkushtimi i grupit punues të komunës së Hanit të Elezit i cili në mënyrë të veçantë e ka shtjelluar këtë problematikë në përputhje me planet zhvillimore strategjike.

Ata që në veçanti duhet t'i falënderojmë janë partnerët tanë nga projekti "Zvicër-Kosovë përkrahje qeverisjes Lokale dhe Decentralizim LOGOS", i implementuar nga HELVETAS Sëëiss Intercooperation, i financuar nga Qeveria Zvicerane. Këta partnerë me ekspertiza profesionale, shkëmbim të përvojave dhe udhëtime studimore ia mundësuan grupit punues hartimin e këtij dokumenti.

## 1. Hyrje

Struktura për përgatitjen e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM) është bazuar në legjislacionin kombëtar “Ligji për Mbeturina” (No.04/L-060), dhe me mbështetjen e HELVETAS, Programi DEMOS.

Objektivi i këtij PKMM është që të analizon situatën aktuale të menaxhimit të mbeturinave në tërë territorin e komunës (organizimi, administrimi, rregulloret, financat, operimi dhe menaxhimi), identifikon çështjet dhe mangësitë, vlerëson pikat e forta dhe të dobëta, propozon rekomandime për përmirësime dhe përcakton vizione, qëllime dhe objektiva të reja (afatshkurtra, afatmesme ) si edhe ka hartuar një Plan Veprimi ku përcaktohen afatet kohore, kostot, autoritetet përgjegjëse si edhe indikatorët respektivë të suksesit për qëllime monitorimi.

PKMM trajton vetëm mbeturinat e ngurta, nuk përfshihen mbeturinat e veçanta të cilat nuk janë kompetencë e komunës. Por do të përfshij raportimin e këtyre mbeturinave te institucionet përgjegjës siç është MMPH.

### 1.1. Misioni, vizioni dhe objektivat

#### Vizioni

Komuna e Hanit të Elezit duke u bazuar në synimin e përgjithshëm do të sigurojë që shërbimet për rreth menaxhimit të mbeturinave të përfshijnë e 90 % të banorëve të komunës.

#### Misioni i Komunës për Shërbimin e Mbledhjes së Mbeturinave

Komuna e Hanit të Elezit do të angazhohet maksimalisht për zgjerimin e Shërbimit të Mbledhjes së Mbeturinave dhe për ngritjen e cilësisë së shërbimit. Kurse në një afat sa më shkurtër, komuna e Hanit të Elezit planifikon që shërbimin e mbledhjes së mbeturinave të bëjë në formë më modern respektivisht përmes mbledhjes së diferencuar për të inkurajuar riciklimin dhe reduktimin e mbeturinave

#### Masat e Shërbimit te Grumbullimit te Mbeturinave:

1. *Masa e Parë* - Ngritja e Cilësisë së Shërbimit në mënyrë të qëndrueshme dhe respektimi i standardit nga të gjithë ata të cilëve u ofrohet shërbimit.
2. *Masa e dytë* - Rritja e Mbulshmërisë me Shërbimin e Grumbullimit të Mbeturinave dhe përmirësimi i situatës financiare që lidhet me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbeturinave.



## 2. Profili i Hani i Elezit

Hani i Elezit me rrethinë shtrihet në pjesën më jugore të Republikës së Kosovës, në kufij me Republikën e Maqedonisë. Ka një sipërfaqe prej 83 km<sup>2</sup>, në mes të maleve të Sharrit në perëndimi dhe Karadakut (Rodope) në lindja.

Komuna ka gjithsej 11 zona kadastrare, dy prej të cilave kanë qenë të shpopulluara që nga viti 1999. Sipas të dhënave të mbledhura në terren për nevoja të planifikimit, popullata është vlerësuar të jetë 9.403 banorë. Që nga themelimi i fabrikës së çimentos në vitin 1936, numri i popullsisë në Hanin e Elezit është rritur vazhdimisht. Tabela në vijim paraqet shpërndarjen e popullsisë në secilin vendbanim.

*Tabela 1. Numri i popullsisë për çdo vendbanim*

Lokaliteti	Popullata	Sipërfaqja ne km2	Nr i ekon.famijare
Hani i Elezit	3,749	1.2	578
Paldenicë	1,750	4	270
Secishtë	1,002	8.4	154
Gorancë	957	20.8	147
Rezhancë	749	8.4	115
Pustenik	612	10.9	94
Krivenik	306	12.3	47
Dimcë	215	1.9	33
Dermjak	49	6.1	7
Neçavc	4	4.4	1
<b>Total</b>	<b>9,403</b>	<b>78.4</b>	<b>1446</b>

Hani i Elezit është një vend me zhvillim industrial, fabrikat të njohura në këtë zonë janë fabrika e çimentos "Sharrcem" dhe fabrika e stiroporit "KosovaPlast."

Pasojat negative të Hanit të Elezit, si vend i zhvilluar industrial, është se ka ndotje të gjerë. Ndotja është e pranishme në tokë, ajër, ujë, zhurmë (në sasi më të vogël) dhe ndikimin në peisazh për shkak të shfrytëzimit të pasurive natyrore. Faktin që Hani i Elezit kishte interes ekonomik dhe social, që nga hapja e fabrikës së çimentos në vitin 1936, u konsiderua si "pikë të nxehtë" e Kosovës nga aspekti i ndotjes. Përkundër përmirësimit të teknologjisë në fabrikën e çimentos, ndotja është ende evidente dhe efektet e viteve të rënda të ndotjes janë ende, shihen në mjedis. Ekzistenca e fabrikës për prodhimin e asbest çimentos ka kontribuar shumë në ndotje, gjë që është e dukshme në të gjitha fushat. Asbest çimentoja është përdorur shumë në të gjitha format e saj, për mbulimin e çatave, tuba të ujit dhe elemente tjera në të gjitha llojet e ndërtesave dhe vende tjera publike. Çështje tjetër është popullata, që ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me asbestin e palidhur.

Ndikimi i industrisë në mjedis mund të tregohet përmes ndikimit në ajër, ujë dhe sipërfaqen e tokës, ndikimit nga zhurma, mbetjet industriale dhe ndikimi në peisazh nga mineralet e përdorura.

### ***Ndotja e ujit***

Ndotja e ujit në lumin Lepenc dhe rrjedhat e saj nga mbeturinat e pa trajtuara të sistemit të ujërave të zeza, e kombinuar me ndotjen kimike nga industria e rëndë në këtë region, ndikon në ndotjen e përgjithshme në Han të Elezit. Në Planin Hapësinor të Kosovës, ndotja e lumit Lepenc rangohet në kategorinë "IIa" nga "IV" kategoritë. Bazuar në studimet e fundit dhe të dhënat nga aspekti kimik dhe bakteriologjik, cilësia e lumit Lepenc bie nën kategorinë e katërt të ujit, bazuar në standardet e cilësisë së ujit. Natyrisht që Hani i Elezit ka ndikimin e saj në këtë proces të ndotjes.

### ***Ndotja e dheut***

Ekziston një rrezik i madh i shkaktuar nga grumbullimi i mbeturinave të ngurta dhe mbetjet toksike kancerogjene nga prodhimet e asbest çimentos, të cilat mund të shihen përgjatë brigjeve të lumit në gjithë zonën. Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave të ngurta, shfrytëzimi i paligjshëm i lëndëve të para për prodhimin e çimentos, mosmirëmbajtja e rrjedhave të përrrenjve, mungesa e zonës së gjelbër në mes të zonës industriale dhe pjesëve tjera të qytetit etj. Gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e përgjithshme në Han të Elezit.

## **2.1. Korniza kombëtare ligjore dhe politikat**

- Menaxhimi i mbeturinave në Republikën e Kosovës rregullohet përmes Kornizës Ligjore e cila është e harmonizuar me legjislacionin evropian respektivisht direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian të cilat rregullojnë sektorin e mbeturinave. Qëllimi kryesor i kornizës ligjore për menaxhimin e mbeturinave është evitimi dhe reduktimi në masë sa më të madhe të mundshme të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut si dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.
- Korniza ligjore përbëhet prej ligjeve dhe akteve nënligjore të cilat rregullojnë menaxhimin e mbeturinave. Ligji kryesor i cili në mënyrë të detajuar rregullon menaxhimin e mbeturinave është Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina. Ky ligj përcakton dhe rregullon planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave; kushtet për grumbullimin e mbeturinave, transportin, trajtimin, magazinimin dhe asgjësimin, llojet dhe klasifikimin e mbeturinave, përgjegjësitë e personave juridik dhe fizik lidhur me menaxhimin e mbeturinave, kushtet dhe procedurat e licencave dhe lejeve për menaxhimin e mbeturinave, ndëshkimet për mosrespektimin e dispozitave ligjore si dhe çështjet tjera lidhur me mbeturinat. Neni 14 dhe 15 i Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, përcakton përgjegjësit për menaxhimin e mbeturinave të institucioneve të nivelit qendror dhe nivelit lokal. Me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, komuna merr përgjegjësi shtesë lidhur me menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave.
- Përveç ligjeve të lartpërmendura, Korniza Ligjore për menaxhimin e mbeturinave përmban edhe një numër të konsideruar të ligjeve tjera dhe sektoriale të cilat në mënyrë

indirekte rregullojnë menaxhimin e mbeturinave, siç janë: Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, etj.

- Neni 17 i Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përcakton menaxhimin e mbeturinave si kompetencë të plotë dhe ekskluzive të komunave. Në bazë kësaj kompetence Komunitat kanë autorizim ligjor të krijojnë struktura, mekanizma si dhe të parashohin buxhet të veçantë me qëllim të menaxhimit sa më të mirë dhe efikas të sektorit të mbeturinave.
- Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton dhe rregullon pronësinë e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave, udhëheqjen korporative të tyre në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare. Neni 6 i Ligji Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike mundëson krijimin e ndërmarrjeve publike lokale nga komunitat. Ndërsa me nenet 4, 5, 6 të Rregullores Nr.02/2013 përcaktohen kriteret dhe procedurat për krijimin e ndërmarrjeve publike për menaxhimin e mbeturinave. Në bazë të nenit 5.2 të këtij ligji të drejtën e komunës si aksionar e ushtron Komisioni Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga: një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare.

## **2.2. Korniza lokale ligjore**

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe ligjet tjera sektoriale, komuna është e obliguara të krijoj kornizën lokale ligjore me qëllim të menaxhimit sa më efikas të mbeturinave në territorin e tyre. Kornizat lokale përbëhen nga rregulloret komunale, udhëzimet, politikat, rregullatorë të ndryshëm, dhe vendimet që rregullojnë sektorin e menaxhimit të mbeturinave.

Në kuadër të kornizës lokale ligjore, komuna ka miratuar: Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, Rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit dhe Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Mjedisit.

### 3. Gjendja aktuale

#### 3.1. Grumbullimi dhe përbërja e mbeturinave

Mungesa e të dhënave zyrtare për sasinë dhe përbërjen e mbeturinave të grumbulluara. Analizat e mostrave (të dhënave) të realizuar në vitin 2011, të cilat nuk kanë pësuar ndërrime të rëndësishme, vazhdojnë të jenë aktuale edhe këto vite. Është e mundur të vlerësohet shuma e përgjithshme e gjenerimit të mbeturinave në komunën e Hanit e Elezit, si dhe përbërja e mbeturinave të grumbulluara (Tabela 3). E nevojshme për planifikimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të mbeturinave të ngurta.

Mostrat e shqyrtuara lidhur me grumbullimin e bërë gjatë vitit 2011 në lokalitet Seqishtë, Paldenicë dhe Hanë të Elezit, mesataret e të cilave janë ndarë sipas numrit të banorëve të shërbyer dhe gjenerimit të mbeturinave ditore për person janë vlerësuar të jenë 0.25 kg/për person. Tabela 4 paraqet vlerësimet e niveleve të gjenerimit të mbeturinave të përdorura në këtë raport.

Tabela 2. Sasia e Grumbullimi të mbeturinave në ditë, muaj dhe vit

Kategoria	Vlera
Popullata	<b>9,403</b>
Familjet	1,449
Vlera e mbeturinave të mbledhura në ditë për person (kg)	0.25
Vlera e mbeturinave të mbledhura në muaj për person (kg)	7.49
Vlera e mbeturinave të mbledhura në muaj (Ton)	70
Vlera e mbeturinave të mbledhura në vit (Ton)	856

Pagesa mujore për shtëpi është 3.00€ dhe lokale afariste €<sup>00</sup>-€<sup>00</sup>, kurse përqindja e inkasimit është 25-30%, mirëpo për tarifën në vijimi do të vendos kuvendi me rregulloren për taksa dhe tarifa. Vlerësimi vjetor i mbeturinave të gjeneruara në Hanin e Elezit është 1.876.65 T/vit. Informatat rreth përbërjes së kësaj sasive janë thelbësore për planifikimin e procesit të trajtimit të mbeturinave për periudhën e ardhshme.

Tabela 3. Përbërja e Mbeturinave – kriteri mbeturinat e gjeneruara te përlogaritura

Lloji	Kosovë	Hani i Elezit	Kosovë /Metur.	Hani i Elezit /Mbet.	Difer.
Mbeturinat organike (kuzhinë dhe kopsht)	35%	36%	786	797	11
Qelq	21%	12%	468	263	(204)
Dru	11%	14%	245	316	71
Mbeturinat plastike (shishet dhe paketimet)	9%	9%	209	209	(1)
Metalet	9%	11%	207	248	41
Tekstil	8%	14%	183	301	118
Letër dhe karton	5%	4%	102	92	(11)
Mbeturina të rrezikshme amvisërie	1%	0%	27	2	(25)
<b>Total</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>2,226</b>	<b>2,226</b>	

Figura 1. Vijat e grumbullimit të mbeturinave në komunën e Hanit të Elezit







Figura 2.Harta 1: Vijat dhe oraret e mbledhjes së mbeturinave

**E Hënë (08:00-16:00) (33km)**

Krivenik 09:00-10:00,  
 Seqishtë(rr.UÇK-  
 së10:00-10:30  
 rr. Veli Ballazhi10:30-11:00  
 rr.SuadBarava 11:00-11:30,  
 Dëshmorët e Krivenikut 11:30-  
 12:00).

**E Martë (08:00-16:00) (8km)**

Rr. Adem Jashari 09:00-  
 10:00,  
 Dëshmorët e Kombit 10:00-  
 10:30,  
 Xhemsedin Suma 10:30-11:00  
 Nuri Bushi 11:00-11:30 ,  
 Isa Berisha 11:30-12:00, Lagjja e  
 Vlashve12:00-12:30

**E Mërkurë (08:00-16:00) (20km)**

Gorancë09:00-10:30  
 Rezhancë10:30-11:00  
 Hunel11:00-11:15  
 Kollomoqe11:15-11:30  
 Meliq 11:30-12:00 Brava  
 12:00-12:30  
 Të Përndjekurit 12:30-13:00

**E Enjte(08:00-16:00) (14km)**

P aldenicë9:00-10:00 Driton  
 &GafurrLoku 10:00-11:00  
 Elham Curri 11:00-11:30 Imri  
 Curri11:30-11:30-12:00, Izet  
 Bushi 12:00-12:30, Imer Vila  
 12:30-13:00.

**E Shtunë (08:00-16:00) 8km)**

Adem Jashari 09:00-10:00, Dëshmorët e  
 Kombit 10:00-10:30 XhemsedinSuma10:30-  
 11:00 Nuri Bushi 11:00-11:3  
 Isa Berisha 11:30-12:00, Martirët Bushi  
 12:00-12:30, Isen Suma fsh.Dimcë 12:30-  
 13:00.

Tabela 4. Territori dhe shtrirja e shërbimit

Kategoria	Popullata e përgjithshme			Popullata e mbuluar me shërbimet		
	Zona Qyteza	Zona Rurale	Gjithsej	Zona Qyteza	Zonat Rurale	Gjithsej
Ne Numër	4,706	4,683	9,389	1,268	1,662	2,931
Ne %	50.1%	49.9%	100.0%	26.95%	35.50%	62.45%

### 3.2 Deponimi i mbeturinave

Hani i Elezit ka të drejtë ta përdorë stacionin e transferimit të mbeturinave në Ferizaj. Kapaciteti i tij i përgjithshëm është 50,000 m<sup>3</sup>; kapaciteti mujor 2,500 ton. Stacioni i transferimit i shërben popullsisë prej 210,120 përkatësisht komunave: Ferizaj, Shtime, Hani i Elezit dhe Hani i Elezit


### 3.3 Analizat e përbërjes së mbeturinave

Përbërja mbeturinave në mostrat e analizuar në pesë lokacione të Hanit të Elezit tregojnë se 35% e sasisë së përgjithshme të mbeturinave është organike. Rreth 20% i takon produkteve higjienike (pelenat), e përcjell nga plastika dhe mbetjet tjera. Gjersa metalet dhe qelqi përbejnë më pak se 2% të mbetjeve të analizuar.

Figura 5. Analiza e ndarjes së mbeturinave (në %)

Përbërja	Ne %	Mbeturinat(Ne tone)
Mbeturinat e kuzhinës	42.0%	935
Letra	13.6%	303
Tjera	11.5%	256
Plastika	10.6%	236
Hiri i nxemjes	8.3%	185
Gjami/shishet	4.9%	109
Bari & druri(mbetjet e gjelbërta)	2.9%	65
Hiri/dheu	2.9%	65
Metali	1.3%	29
Tekstili	1.2%	27
Qeramika & guri	0.5%	11
Goma dhe lëkura	0.3%	7
<b>Totali</b>	<b>100.0%</b>	<b>2,226</b>

Figura 4. Mbeturinat e ngurta, të riciklueshme dhe të përbëra (2011)



### **3.4. Studimi në terren .**

Rezultatet e vlerësimit të mbeturinave që tregojnë se nga shuma totale e mostrave të mbeturinave të mbledhura, sasia që është e riciklueshme dhe e ndarë në lloje të mbeturinave (letër, plastikë dhe qelq) dhe llojet e mbeturinave organike të përbëra përfaqësojnë 51% në Han të Elezit. Veç kësaj, ka indikatorë se sasia e mbeturinave që transferohet deri tek deponitë mund të reduktohet ndjeshëm me ndarjen e mbeturinave, dhe me prezantimin e procesit të kompostimit në zonat rurale.

Përqindja e ulët e metaleve në mbeturinat e amvisërisë (më pak se 2%) rezulton për shkak të faktit se kanoçet nga alumini janë duke u mbledhur me të madhe (edhe pse jo në mënyrë të organizuar), pasi që ky është një aktivitet fitimprurës. Gjatë analizave tona të mbeturinave u vu re një sasi tejet e madhe e pelenave (deri në 18%). Kjo ka edhe një vëllim të madh, dhe nuk ka mundësi për riciklimin, ripërdorim apo reduktim.

Sistemet aktuale të grumbullimit të mbeturinave në Han të Elezit nuk i mbulojnë të gjitha fshatrat me shërbimet e tyre. Një nga pengesat kryesore për kompanitë e tanishme dhe të ardhshme për grumbullimin e mbeturinave në Han të Elezit është distanca 60 km nga kjo komunë për në deponinë rajonale, gjë që rrit koston e veprimeve të tyre.



## 4. PLANIFIKIMI OPERACIONAL I MENAXHIMIT TE MBETURINAVE (2016-2020)

PKMM është një dokument planifikimi strategjik, që komunës së Hanit të Elezit i mundëson zbatimin e politikës kombëtare për mbeturina në nivel komunal. PKMM tregon një drejtimin të cilin do të ndjekin autoritetet komunale në të ardhmen. Qëllimi është të orientojë autoritetet komunale drejt masave praktike dhe veprimeve në lidhje me grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave.

Posaçërisht, PKMM në rastin më të mirë synon të ofrojë:

- 1. Përputhjen me Strategjinë Kombëtare të Mbeturinave dhe objektivave të saj:** duke kontribuar në zbatimin e politikave të menaxhimit të mbeturinave dhe në arritjen e objektivave kombëtarë.
- 2. Përshkrimin e karakteristikave të mbeturinave:** duke dhënë një përshkrim të vijave së mbeturinave dhe përgjegjësive për to, vëllimin e mbeturinave që duhet të administrohet dhe karakteristikat e tyre, si dhe përcaktimin e shtrirjes gjeografike të planit etj.
- 3. Një vlerësim të skemave ekzistuese të grumbullimit të mbeturinave, pajisjeve dhe personelit të përfshirë si dhe instalimeve kryesore të depozitimit dhe rikuperimit:** për të përcaktuar gjendjen ekzistuese të shërbimeve dhe aktiviteteve të MM-së.
- 4. Alternativat e menaxhimit të mbeturinave:** me qëllim mundësimin e grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtarë dhe kontekstit komunal; për më tepër, ndihmon në identifikimin dhe vlerësimin e teknikave për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, vendet dhe teknologjitë për trajtimin, depozitimin, riciklimin e mbeturinave.

Komuna e Hanit të Elezit ka për detyrë të mundësojë ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, pastrimin e rrugëve, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave urbane dhe atyre rurale. Për t'u arritur ky synim, autoriteti komunal në bazë të kornizës ligjore e cila aktualisht zbatohet në Republikën e Kosovës ofrimi i shërbimit të mbeturinave dhe operimit mund realizohet në katër modalitete, të cilat janë si më poshtë:

1. Organizim nga vetë autoriteti komunal ndërmarrje publike komunale.
2. Organizim Regjional (ndërmarrje publike Regjionale).
3. Organizim i deleguar i shërbimit tek ndërmarrja/operatorët privat.
4. Organizim i përbashkët i shërbimit (publiko-privat).

### 4.1. Modeli i zgjedhur i operimit

Pas tentimit të pasuksesshëm 5 vjeçar për të themeluar ndërmarrjen komunale për menaxhim me mbeturina, dhe analizimit me kujdes të alternativës së autoriteti komunal ka marr vendim që në periudhën e ardhshme 5 vjeçare të përcaktohen në model të kombinuar publik dhe atë privat. Më saktësisht në atë të:

- Operimit me Operator Publik (Ndërmarrje Publike Rajonale), dhe
- Operator Privatë.

Mirëpo duhet të theksohet se autoritetet e larta të komunës janë shumë të interesuar për të themeluar ndërmarrjen publike komunale por për shkak të paqartësive ligjore dhe burokratike për momentin nuk është e mundur të bëhet një gjë e tillë prandaj deri në rishikimin e radhës të planit komunal. Autoritet e komunës kanë filluar bisedimet me përfaqësuesit e KRU Pastërtia me seli në Ferizaj, dhe janë të pajtimit që banorët të shërbehen nga KRU Pastërtia, me mundësi me angazhimit edhe të operatorëve privat.

#### **4.2. Synimet kryesore në fushën e menaxhimit të mbeturinave**

Me qëllim që të arrihen objektivat e synuar për periudhën e planifikuar 2016-2020, Komuna e Hanit të Elezit do të realizoj këto aktivitet afatmesme:

- Themelimi i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave në kuadër të DSHPE-së ose caktimin e një zyrtari për MM.
- Përcaktimi i Zonave të Operimit
- Themelimi i Ndërmarrjes Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave

#### **4.3. Hartimi i Rregulloreve Komunale për rregullimin e fushës së menaxhimit të mbeturinave.**

Sipas kornizës ligjore në fuqi secila komunë në territorin e Republikës së Kosovës duhet të ketë kornizën e vet rregullative me të cilën bëhet menaxhimi i mbeturinave në gjithë territorin komunal. Në kuadër të kornizës vendore përfshihen rregulloret komunale, udhëzimet, politikat, dhe vendimet që rregullojnë sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Me qëllim rumbullakimit të kornizës rregullative komuna e Hanit të Elezit gjatë periudhës 2016-2020 duhet miratoj këtë akt komunalë:

- Rregulloren për themelimi e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave
- Rregulloren për themelimin e Ndërmarrjes Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

#### **4.4. Sektori për menaxhimin e mbeturinave**


Për të realizuar planin për menaxhimin e mbeturinave Komuna e Hanit të Elezit duke filluar nga viti 2017 në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë do të themeloj Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave, i cili do ti ketë këto përgjegjësi :

- Do të bëjë zbatimin dhe mbikëqyrjen e planit për menaxhimin e mbeturinave,
- Do të hartoj planet operative për grumbullimin dhe trajtim të mbeturinave, duke i caktuar zonat e operimit ,
- Do të caktoj tarifatat dhe kushtet për operatorët që merren me grumbullim, transportim dhe trajtim të mbeturinave, si dhe do të bëjë monitorimin dhe vlerësimin e këtyre kompanive,

- Në bashkëpunim me akterët gjegjës të zhvilloi procedura dhe aktivitete për monitorim të aktiviteteve që zvogëlojnë sasinë e hedhjeve ilegale, të zhvilloi dhe menaxhoi planet për eliminim të pikave me mbeturina ilegale,
- Në bashkëpunim me akterët gjegjës të zhvilloi pilot projekte që kanë për qëllim përmirësimin e performancës së Komunës në lëmin e menaxhimit të mbeturinave,

Në fillim sektori do ketë 3 zyrtar të cilit do të përkujdesen për të gjitha aspektet e menaxhimit të mbeturinave në territorin e komunës. Në të njëjtën kohë do të shërbej edhe si zyre për hartimin dhe rishikimin e planit për menaxhimin e mbeturinave. Sektori në fjalë do të ketë një udhëheqës, një zyrtar për menaxhimin e mbeturinave dhe një zyrtar për planifikim.

Fig. 5 - Skema Organizative e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave



#### 4.5. Skemat e Ofrimit të Shërbimit të Menaxhimit të Mbeturinave

